

Prend BUZHALA

KODI ROMANOR I MISTERIT TË DASHURISË

Një temë dashurie, që përcillet e trazohet nga hija e ankthi i një krimi kërcënues. Një dramë e ndjesive të erosit që përfundon me hepiendin e dhurimin e gëzimit të lumturisë. Ky është sfondi i përgjithshëm i romanit, strukturat narrative të të cilit sillen në ambiente të ndryshme (në mërgim, nëpër Evropë, dhe përfundojnë në SHBA, në Nju Jork), nëpër ambientet etnike shqiptare e familjare, duke u përqendruar te punktet rrëfimorë-tematike: dashuria, puna, familja, mërgimi, etnia, kultura, arti, poezia, jeta urbane...

1. Poetika e paratekstit:

kur romani thur ideografinë autoriale të personazhit

Romanit të tij Besim Xhelili i ka dhënë një titull specifik "1803" që shënjon datën 18 mars kur zë fill rrëfimi romanor për dashurinë. Në fillim autori ka vënë dy paratekste që shënjojnë semantikën dhe poetikën e veprës. Te parateksti i parë dashurinë e quan forcë hyjnore që dhuron gëzim dhe lumturi:

"Dashuria e saj më shëroi dhe më dha jetë...",

kurse te parateksti i dytë e vërteta dhe imagjinata kanë ndërthurjet e tyre, sipas ligjësive të artit, madje autori e vë në kornizat e rrëfimit imagjinativ edhe emrin e tij, edhe të personazheve tjerë e ku protagonistë kryesorë shfaqet emri autorial nën emblemën ideografike të një emri të ri, Besarit: (*"autori ia ka ngarkuar tërë ngjarjen personazhit kryesor mashkull në roman dhe po ashtu edhe personazhit kryesor femër, që nuk do të thotë se mu ashtu ka rrjedhur ngjarja dhe jeta e tyre."*), si dhe personazhit femër, Samires (*"që nuk do të thotë se mu ashtu ka rrjedhë ngjarja dhe jeta e tyre. Është vetëm një rastësi përzgjedhja e temës dhe personazheve të romanit."*).

I ndërgjegjshëm, pra, se B. Xhelili po shkruan një roman, ai nuk lë pa e afishuar ideografinë e tij krijuese: *"Përparësi i është dhënë artit, mendimit të lirë dhe lirisë së të shprehurit."* emri i tillë ideografik, luan edhe rolin e bartësit të rrëfimit, nga se ai është dhe njeri i shkrimit (*"Unë merrem nga pak me shkrime. Kam botuar katër libra me poezi."*).

Sado që kapitujt e parë japin tipin e romanit- ditar, a tipin e një romani udhëpërshkrues; sado që kapitujt tjerë mbushullohen vetëm me tekste të ndërthurura me dialogë lirikë e me përshkrime lirike të situatave të dashurisë; megjithatë vepra ka sistemin e saj të motivacionit artistik me zgjidhjet kompozicionale-tematike të gjetura e të pëlqyeshme.

2. Rrëfimi i hapur: vlerat harmonike të kuptimit të jetës dhe dashurisë

Të dy protagonistët e dashuruar (njihen e takohen rastësisht në një orë letrare), kanë familjet e tyre, kanë fëmijët dhe jetën e tyre bashkëshortore... dhe autori e ruan sensin e masës në këtë ndërthurje kaq të ndërliqshme e të ndjeshme raportesh e marrëdhëniesh: në dashuri nuk bën të ndjehet i lënduar askush, sipas atij parimit aristotelian, *“E bukur është ajo që është harmonike”!*

Protagonistët e jetojnë dhe e përjetojnë jetën e tyre emocionale përafëruese, si dhe dëshirat e tyre; për ta nuk ka kohë, as natë, as ditë, as të djeshme e as të ardhme, ka vetëm çaste të mbushura me bukurinë e emocionit (bisedat me telefon, emailt, letrat, poezitë, thëniet dashurore, video-bisedat, deri te takimet e rralla... largësia zhduket); ata e pranojnë këtë ndjesi që i jep kuptim jetës së tyre. E pranojnë në çdo kohë e në çdo minutë, në rrugëtim, në shtëpi, në ambiente pune a familjare...

Së këndejmi, kah fundi i romanit, askush askënd nuk e akuzon për këtë dashuri, por përkundrazi triumfon mirëkuptimi! Madje, do të thoshim me gjuhën e Koeljos, triumfon përvoja e lirisë, mbasi qeniet nuk e posedojnë njëri-tjetrin, pikërisht kur e ke pjesë të qenies sate gjënë më të vlefshme në jetë e në botë! E po ky Paulo Koeljo do të thoshte:

“Dashuria është ushqim i ekzistencës sonë, e nëse nuk e pranojmë, e hedhim, do të vdesim nga uria, duke i shikuar degët e thata në trungun e jetës, pa guximin për ta shtrirë dorën dhe për t’i vjelë frytet.”

Kësisoj, protagonistët nuk i reshten kësaj ndjesie dhe frytet e tyre jepen në tekstin e epilogut të romanit... pas përjetimit të ngjarjeve në disa linja: protagonistin kryesor kërcënohet për vdekje (ai ka incizuar vrasjen e një qytetari), madje në fund të romanit ai përgjaket nga thika e një krimineli që përpiqet me çdo kusht ta mbulojë krimin... dhe, në fund, marrim vesh se ai vuan edhe një tumor në kokë.

Të duket sikur në këtë hapje zemrash e jetësh, ndërgegjeshëm, mund të ndodhë që zemrat e protagonistëve edhe mund të thyhen, të copëtohen; sikur te këta dy të dashuruar nuk duan të afrohen përfundimisht, për shkak se janë tepër të mirë për njëri-tjetrin, tepër të përsosur në këtë ndjesi, për t’i ikur lëndimit... Ti ia nis aventurës së përjetimit të tillë me bindjen se dashuria shpëton e dhuron lumturi; kurse aty qëndron vetëm një vijë e hollë e rënies në situata edhe më të rënda... Këtë mister të dashurisë e ka kuptuar dhe koduar edhe protagonistin që merr rolin e rrëfimitarit fiktiv: për ta kapërcyer këtë thyerje, ky emocion i do lëndimet, i vuan ato... pikërisht pse kjo ndjesi dhuron çastet e epërme, pasionante, të ekzistencës, dhe pikërisht pse, pa këtë ndjesi, jeta nuk arrin në majat më të larta të jetim-përjetimit dhe gjallimit. Lexuesi, mbasi, do të priste përshkrime të situatave përtej një erosi, ashtu sikundër jepen skenat seksuale në filma apo në literaturën e lehtë të romaneve

sentimentalë. Por jo, sepse te ky roman protagonistët e përjetojnë pasionin e dashurisë, prandaj, edhe kur takohen, ata përqafohen me afsh pasionant. Ky pasion jepet në secilën faqe, me anë të dialogëve lirikë, me shikimet e “takimet” me anë të teknologjisë moderne të komunikimit, me dhurime gjërash krejt të rëndomta (imazhe a figurina lulësh, zemrash etj)... Madje, romani duke e shikuar botën përreth me anë të syve të tillë dashurorë, atëherë edhe jeta, edhe realiteti, edhe familja marrin peshë të veçantë...

Vizionet e lumturisë janë të shumta, ato nuk mbyllen në një çark rrethanash të krijuara si histori të padëshiruara të qenieve që jeta vetëm i ka ofruar me anë të një kontrate-martese (si i kandodhë Samires) mbase dhe protagonistit narrator e që duan ta gjejnë të realizuar qenien e tyre me çdo kusht tani, te një përjetim-shtegtim i ri jetësor.

Ndryshe nga veprat letrare moderne (dhe postmoderne) që e trajtojnë boshllëkun e ekzistencës njerëzore, duke e humbur dhe shpirtin e vet; kjo vepër i thur një himn kuptimit të jetës, vlerave harmonike të saj. Këta protagonistë nuk këlthasin si te romanet e absurdit: se nuk paska shpëtim! Jo. Sepse këta protagonistë kanë vetëdijen e tyre të zgjuar për ta kapërcyer rubikonin e ngushtësisë së këndshikimit, vizionin paragjykues e aq të ngushtë mbi vlerat e jetës. Ata nuk kanë nevojë ta ndryshojnë vetveten, as personalitetin e tyre,; nuk ndiejnë nevojë as ta ndryshojnë stilin e jetës, madje as lidhjet martesore, përpos që ndiejnë nevojë t’i dhurojnë njëri-tjetrit dashuri e që ua dhuron dhe qetësinë parajsore të ekzistencës.

3. Shtresat narrative: nga panorama e gjerë e jetës deri te kultura e etike

Një ëndërr që shqetëson personazhin, si bartës rrëfimi, është dhe parandjenjë e ngjarjeve që do të ndodhin (“Ëndrra nuk më hiqet nga mendja. Doja ta rikujtoj ngjarjen, por edhe nuk dua që ajo të më preokupojë aq shumë. Një gjë e di sigurt. Kishte të bënte me punën time”). Kësisoj, romani shtresohet dhe me nuancimet psikologjike, të cilat kornizojnë dramën e brendshme intime dhe familjare, të personazhit ideografik.

Mirëpo, e brendshmja, bota shpirtërore a psikologjikja, qëndrojnë gjithnjë në harmoni me panoramën e jashtme të ngjarjeve: me jetën urbane, me ambientet, me dekorin e jashtëm (“vozis në Linjat që kalojnë nëpër Unazë. Shoh shumë gjëra dhe i shijoj. Takoj dhe vështroj shumë turistë, njerëz të ndryshëm nga kultura e zakone të ndryshme. Kam bërë një listë me këngë të mira, të zgjedhura dhe i dëgjoj në telefon sa herë që jam rrugëve. Në hyrje të Metrosë me gazetatat në duar pret si gjithnjë ndonjë i ri.”)

Duke gërmuar në jetën e personazheve, e kaluara përmban shtresime të shumta të botës së karaktereve. Kështu, fëmijëria këndvështrohet me nostalgjinë, bukurinë a marrëzinë e dikurshme (“Mbah mend në moshën 12-vjeçare kur nisa të pi cigaren. Më kujtohet si sot kur shokët ma ngjitën. Haj provoje vetëm pak, më thanë në fillim. Pastaj kaq mjaftoi. Ky

qe njëri nga gabimet më të mëdha që bëra në jetë. 15 vjet kam pirë dhe tash e 13 vjet që e kam ndaluar.”). Mirëpo, kjo shtysë retrospektive e personazhit përbën, po ashtu një nënndër përcaktueset (frojdiiane) të karakterit të njeriut në situatat e mëvonshme, ku ndërvoja e djeshme e shtyp të sotmen e tyre (siç ndodh me keqbërësin që shndërrohet në vrasës, në psikopat që vret një koleg, serb).

Këso shtresimesh tumiren për t’u dhënë zë dhe vlerave të tjera të jetës dhe ekzistencës, për t’i shquar, sidomos, vlerat etike. Njerëzit çdo ditë e manifestojnë vetveten në mënyrën e veprimit, sjelljes, të kuvendimit, paraqesin gjykimet e vlerësimet e tyre morale, nga fusha të ndryshme të jetës, qofshin ato familjare, politike, shoqërore, arsimore apo nga ajo e dashurisë, artit a kulturës, dhe, në këtë kontekst, edhe në fushën etnike a atdhetare:

“Djathtas kalova pranë Pallatit Belvedere, ku Naim Frashëri, kur do vizitonte armët dhe përkrenaren e Skënderbeut do shkruante: ‘Lum ti, moj Shqipëri’ thashë,/ Armët e ti’ kur i pashë/Ndë Belvedere në Vjenë,/Sikur pashë Skënderbenë.’ “ Madje, pasazhe të tëra përshkrimesh e udhëpërshkrimesh, ndër më të përjetuarat, jepen nga udhëtimet nëpër atdhe, nëpër troje etnike... Vlerat e tilla krijohen si ledhe për mbijetesë dhe për dinjitet njerëzor. Të gjitha këto thjerrëzoren te protagonistin e këtij romani, e ku njeriu duhet ta ketë si strumbullar etik a bosht drejtues në jetë:

“Njerëzia është diçka që nuk blihet. Ajo mbillet në familje, krijohet, kultivohet dhe zhvillohet në personalitetin e çdokujt. As librat nuk të bëjnë njeri. As kishat e xhamitë. Njoh të shumtë që vazhdimisht vizitojnë këto objekte fetare, por kur dalin nga atje janë shërbyes të përbetuar të djallit, dhe bëjnë krejt të kundërtën që kanë dëgjuar atje. Ka të tjerë me disa diploma universitetesh, por përbuzës të pandërgjegjshëm në shpirt, fluturojnë në qiell me hundën e papastër, që kur e ngrenë, mundohen tërë fytyrës t’i japin një pamje të veçantë, duke dashtë të thonë se ja, këtu në këtë fytyrë duhet të shikoni meritat e mia, diplomën.”

E pra, rrëfimtari kërkon që etika (njerëzia) të shërbejë e të formohet si kulturë e jetës. Trajtat a shumësia e diskurseve që përdor autori (letra, emaile, fjalë të urta, proverba dialoguese mbi dashurinë, jetën, artin a njerëzit, vargje, strofa e poezi të tëra poetike, thënie lirike, etj etj), përveçse e luajnë rolin e formësimit artistik, kryejnë dhe funksionin e shkarkimit të brendshëm, a të *katarsës*, të zërit të brendshëm. Duke jetuar në Austri, në një vend europaerëndimor ku njeriu ballafaqohet me dinamizmin marramendës të jetës, duke jetuar në mesin e njerëzve të ardhur nga të katër anët e dheut, në mesin e shtresave që u takojnë civilizimeve e kulturave të ndryshme, religjioneve, e mendësive e paragjykimeve të llojllojta, nuk është e habitshme pse edhe panorama romanore e veprës, do të ndalojë kamerën e saj përshkruese-narrative nëpër kampe pune, nëpër stacione urbane të autobusëve, tramvajeve, aeroplanëve, trenave; nëpër kancelari, galeri, markete, restorante, hotele a sheshe e trotuare. Në roman parakalojnë qytete austriake, daneze, suedeze e deri te ato metropolitane a amerikane. Parakalojnë qytete e krahina shqiptare, peizazhe, toponime malesh e bjeshkësh, lumenjsh e fushash, monumente historike e trashëgimore.

Parakalojnë emra krijuesish e librash, po edhe karakteresh nga popuj të ndryshëm, që vuajnë edhe nga paragjykimet ndaj shqiptarëve, qoftë ai dhe një serb apo një turk. Porse autori-narrator përpiket të vëzhgojë përtej secilit paragjykim dhe shtresa e tillë e diskursit karakterologjik, veças i jep veprës një tjetër thesar humanist. Ka, në këtë valë rrymimesh të ndryshme të punëve, përpjekjeve apo të mendësive, në këtë vorbull dinamike të ekzistencës, dhe pjesë që sintetizojnë bukur këtë rrjedhë të rrëmbyeshme lëvizjesh:

“Shumica e kolegëve mendoj se janë në vendin gabim të punës; disa thua se kanë nga disa universitete të mbaruara, tregojnë aq shumë për etikë dhe estetikë, thua se janë filozofë; disa flasin aq shumë, goja nuk u lodhet kurrë, thua se janë avokatë; disa i dinë krejt ligjet dhe rregulloret, thua se ata i kanë bërë këto ligje, janë ligjvënës; disa të tjerë i dinë krejt gjërat për gratë, thua se janë studiues që prej kohësh ose janë gjinekologë, disa gra kolege në të kundërtën thua se i dinë se çka mendojnë të gjithë burrat, pra vetëm për atë sendin e tyre mes këmbëve mendojmë dhe hiq më pak e hiq më shumë; disa nga vendasit që tashmë gjithë jetën e tyre fitojnë lekun nga udhëtarët, në mesin e të cilëve janë shumë të huaj, emigrantë, ata në pauzë nuk janë në gjendje të përmbahen nga ndjenjat e tyre naziste, ndërsa unë vet jam i emigruar dhe duhet në vend të pauzës të dëjoj fjalët dhe sharjet më të ndryshme, më të ulëta në adresë timen. Kjo është një çmenduri gati kështu çdo ditë.”

4. Thadrimi romanor i lirizmit: Uni ideografik i personazhit

Duke pasur parasysh dhe librin e fundit poetik “Besa” që kushtohet fundekrye dashurisë, lexuesi i vëmendshëm nuk e ka të vështirë të pohojë që lirizmi karakteristik i vëllimit poetik, thadrohët natyrshëm, me frymën e tillë poetike lirike edhe te ky roman. Vlerat lirike të poezisë vijnë të freskëta te ky roman. Meqenëse pjesa dërmuese e kësaj proze po ashtu i kushtohet dashurisë, atëherë pse të mos pohojmë se ajo lexohet si një roman poetik i mirëfilltë. Ja një fragment i tillë:

“A të rri mendja tek ndonjë njeri i veçantë apo tek e gjithë Tetova”, më provokoi me një pyetje.

“Po, te ajo më e veçanta në zemër...”, u përgjigja unë si me paramendim.

“Ahhhhhhhh”, shkroi ajo.

“Te nëna, heheh”, i shkrova prapë.

“Këngë e bukur, sepse ke mall për nënën”, shkroi.

“Padyshim kam mall...por, duhet durim dhe shpresë”, ia lëshova edhe një fjali me paramendim.

“Patjetër, durimi është trëndafili i suksesit”, ma ktheu.

“Trëndafil me gjemba apo pa gjemba?”, e pyeta.

“Trëndafil më aromë të këndshme”, tha.

Unë i ruaj vargjet, poezi shumë e bukur, vetëm titulli mungon”, tha pastaj.

*“Këtë natë të mbetur pa hënë
Ca grimca kujtimesh zgjohen,
Shumë gjëra ende s’i kemi thënë
Por, zemrat tona nuk ftohen.
Dikur kjo zemër nga loti m’u thy
Tek ti tash kërkoj një dashuri...”, vazhdova unë.”*

Tonet e tilla ritmike-dialoguese, të gërshetuara me rënie-ngritjet e dridhmave ritmike të zemrës a frymëmarrjes, të shenjtërimit të emocionit të bukur të dashurisë a të vlerave të urtisë; janë dhe tone kërkimesh, përgjërimesh, pasionesh, oktavash metaforike gjithë temperament... një kundrim metaforik shënjues, përbën edhe titulli i veprës që tregon kohën e nismës së rrëfimit të ëndrrës dhe zhgjëndrrës së realitetit.... Kësisoj, deri në fund! Kërkimi i tillë nuk kërkon shpjegime as rrëfime jofunksionale! Sikur gjuha rationale as për së afërmi nuk arrin t’i artikulojë këto mistere dashurore përafrimi!

Hapësirat e rrëfimit sot kanë evoluuar: më shumë se sa një përshkrues i zakonshëm, rrëfimtari modern reflekton mbi tekstin përshkrues, kurse krijuesi letrar mbështetet mbi një Unë personal, ku gjithçka e ka burimin krijues artistik, e ku ai ngarkohet për të depërtuar nëpër labirintet e realitetit të jashtëm dhe nëpër misteret e botës së brendshme. Ide, reflektim, përshkrim, në ndërkëmbimet racionalja-ndërdija, subkoshienca (si hapësirë entropike frejdiane-romanore).

Në qenësinë e lirizmit romanor nuk ekziston distanca në mes të subjektit (rrëfimtarit, autorit) dhe objektit, lëndës së veprës (si do të shprehej Emil Shtajger): akti i vëzhgim-kërkimit, shndërrohet në akt narrativ.

Sado që është vepra e parë në prozë e Besim Xhelilit, ky roman dëshmon për prirjet e një prozatori të kujdesshëm, që di çka kërkon nga lënda e trajtuar. Romani lexohet lirshëm, me veskun e përjetimit të së bukurës.

Romani i takon veprës me procedim të hapur romanor: sado që mbaron me një hepiend zgjidhjesh tematike-kompozicionale, megjithatë lihet e lirë mundësia e vazhdimit të tij...

Shkurt 2016